



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION, TË MBAJTUR  
MË 21.03.2016**

**MARS-MART  
2016**

Dëgjimin publik e drejtoi Nënkyetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Selvije Halimi

KRYESUESJA: Përshëndetje.

Mirë se keni ardhur në dëgjimin publik për Projektligjin për kundërvajtjet.

Ne si Komision e kemi shqyrtuar në parim dhe në parim ka kaluar në Kuvend, mirëpo kemi vendosur që të bëjmë një grup punues i cili do të merret me amendamentimin e projektligjit dhe gjithashtu fillimisht organizojmë një dëgjim publik.

Të kem një projektligj që është më se i domosdoshëm edhe pse ndoshta mund të konstatojmë se është pak i vonuar por sido që të jetë është i domosdoshëm që të rregullohet çështja e kundërvajtjeve në kuadër të reformave në drejtësi.

Dhe presim kontributin e gjithë atyre të cilët janë ftuar në dëgjim publik, përveç që në takimin e sotëm po që se ata shohin të arsyeshëm të marrin pjesë edhe në takimet e grupit punuese do të merren me amendamentimin e projektligjit.

Deri më tash vetëm OSBE-ja ka dërguar komente për projektligjin nga të tjerët të cilët janë informuar që të marrin pjesë edhe në dëgjimin publik edhe të ndihmojnë amendamentimin e projektligjit nuk kemi ndonjë koment me shkrim.

Për mua personalisht është një çështje që ndoshta Ministria e Drejtësisë do të arrijë që të jap një koment më detal sepse nga përmbajtja e projektligjit shihet që është hequr fare dënimi me burg dhe tash të shohim si është menduar të zgjidhen problemet e natyrave të cilat deri më tash kanë kaluar përmes dënimit me burg dhe se a i kemi kapacitetet me kesi vend që të pranojmë një reformë kaq të thellë edhe pse është mirëpritur dhe është e konsiderueshme. Mirëpo, sa jemi të përgatitur që kundërvajtjet të kalojnë vetëm përmes sanksioneve tjera jo me grupim.

Me qenë se Ministria e drejtësisë është sponzoruese e projektligjit, unë fillimisht kisha japë fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë dhe më pastaj secili që ka komente rreth projektligjit të lajmërohet dhe e merr fjalën sipas radhës.

Faleminderit, shumë edhe një herë për kohën që keni gjet të jeni prezent. Urdhëro, fjala është e juaja!

TAULANT KRYEZIU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucione tjera të pavarura,  
Në cilësinë e këshilltarit të ministrit do të mundohem para jush që ta paraqes një ekspozë për Projektligjin për kundërvajtje. Qëllimet që ne cenojmë të arrijmë me anë të këtij projektligji.

Qëllimi kryesor ka të bëjë me reformimin në tërësi të fushës së kundërvajtjeve si dhe ndikimi pozitivisht në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në shqiptimin dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me kundërvajtje.

Përmes këtij projektligji do të bëhet një reformë thelbësore dhe substanciale të fushës së kundërvajtjes, ku është paraparë siç ju e përmendët largimi i dënimit me burgim dhe për një numër të caktuar të kundërvajtjeve të shqiptohet gjobë përmes organeve kompetente.

Po ashtu është paraparë edhe minimumi edhe maksimumi i shqiptimit të gjobave brenda këtyre organeve si dhe e drejta e atakimit të vendimeve në dy shkallësi brenda organeve dhe mundësia e hapjes së konfliktit administrativ brenda gjykatës kompetente.

Ky projektligj gjithashtu parasheh edhe parimet e përgjithshme të kundërvajtjeve dhe detyron të gjitha aktet tjera ligjore që të jenë në përputhshmëri me projektligjin të cilin ne e paraqesim.

Me anë të këtij projektligji ne synojmë që të rritim efikasitetin dhe efektivitetin edhe gjykatave duke ju mundësuar që për sanksionet dhe për kundërvajtjet e caktuara në momentin që shqiptohet gjoba në qoftë se paguhet në momentin e shqiptimit apo në afatin e paraparë kohor të lirohet 50% nga shuma dhe kjo do t'i mundësoj që lënda të tepërta të jenë në gjykatë dhe të zbulohet numri i tyre dhe gjyqtarët që merren me kundërvajtje të mund të shfrytëzohen nëpër departamente tjera duke ditur nevojën që edhe në departamente tjera ka për gjyqtar të fushave të tilla.

Sa i përket konsultimit besoj që ka qenë një konsultim mjaftë gjithë përfshirës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Se pari me akter profesional me institucione tjera të pavarura, këshillin gjyqësorë, këshilli prokurorial, këshilli gjyqësorë, gjykata supreme po ashtu ekspert vendor dhe ekspertë ndërkombëtarë. Është në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian.

Unë mendoj që k projektligj si i tillë do të ketë mundësi që të diskutohet edhe në kuadër të grupeve punuese, duke marrë edhe shqetësimet eventuale të mundshme që i kemi deri në miratimin final në Kuvend.

Kjo kishte me qenë një hyrje fillestare apo një ekspozë hyrëse sa i përket projektligjit.

Shoqëri me mua është edhe drejtori i Departamentit Ligjor zoti Mentor Borovci, dhe zyrtar të tjerë të cilët kanë qenë direkt të involvuar në përgatitjen e këtij projektligji.

Ne jemi të gatshëm që të ju dëgjojmë dhe të përgjigjemi në çdo shqetësim të juaji.

Ju falënderoj shumë!

KRYESUESJA: Faleminderit!

A e donë dikush tjetër fjalën prej të pranishmit? Po përfaqësuesi i Këshillit Gjyqësor.

ALBER AVDIU:...faleminderit, ju falënderoj edhe unë të gjithëve e falënderoj edhe folësin për fjalimin hyrës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë realisht i angazhuar për përpilimin e draftit të Ligjit për kundërvajtjet përmes ekspertizës të organizuar nga gjyqtarët që ushtrojnë lëmin e kundërvajtjes.

Edhe ne e kemi dërguar në Ministrinë e Drejtësisë disa komente në lidhje me atë se si ne e shohim reformimin e sferës së kundërvajtjeve.

Nëse me lejohet me ju përgjigj pyetjes së juaj direkt në lidhje me dënimin me burg.

Një propozim i tillë ka ardhur prej nesh prej Këshillit Gjyqësor të Kosovës sepse e kemi vërejtur se një sanksionim i tillë si rezultat i kundërvajtjes bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe për qëllim është dashur gjithsesi të mënjanohej nga draftligji për kundërvajtje.

Qëllimi përfundimtar i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës karshi këtij ligji është që të shkarkohet gjyqësori prej lëndëve të kundërvajtjes.

Vetëm sa për informimin tuaj, në vitin 2015 ne kemi pasur mbi pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë lëndë kundërvajtësve. Do të thotë 80 deri 90% të lëndëve thuajse se kemi bërë një raport analitik ende.

Janë lëndë të cilët vijnë direkt mos pagesa e tiketave apo dënimeve të gjobave që shqiptohen në trafik në komunikacion.

Domethënë duke marrë këtë problematik edhe ngarkesën e madhe që po i ndodhe sistemit gjyqësor nga këto lënde

Ne e kemi konceptua një dokument përmes të cilit qëllimi përfundimtar është të shkarkohen sistemi gjyqësor nga lëndet kundërvajtësve, të sillen në sistem gjyqësor vetëm ato lëndë në bazë ashtu siç e përshkruaji zoti Kryeziu si konflikte administrative dhe mandej gjyqtarët të cilët kanë qene të sistemuar në lëndën kundërvajtësve të ngarkohen në lëndë ku i ndodhen raste të vërteta gjyqësorit, rastet penale dhe rastet civile.

Aty është edhe kërkesa me lëndë, aty edhe kemi lëshime me të shumta sa i përket ngarkesës mbi lende dhe kohëzgjatjes së lëndëve.

Kështu që synimi përfundimtar që gjyqtarët të cilët sistemohen aktualisht në lëndën kundërvajtësve, shkarkimi i sistemit gjyqësor prej tyre të risistemohen në departamentet përkatëse civile dhe penale.

Me këtë do të përmbushen një farë mënyre edhe qëllimi afatgjatë i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës që të rritet efikasiteti i punës në sistemin gjyqësorë duke e rritur numrin e gjyqtarëve përbrenda departamenteve në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe do të shkurtohej kohëzgjatja e lëndëve do të thotë me rritjen e numrin e gjyqtarëve do të merr kohë më pak trajtimi i një çështje gjyqësore.

Kjo është pak a shumë në pika të shkurta që ne i kemi pa sy synim në Këshillin Gjyqësor. Besoj që Grupi Punues do të kemi ende disa vërejtje në aspektin teknik më shumë se sa conceptual në mënyrë që të tejkalohen ato edhe të dërgojmë për miratim të fundit në kuvend . Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Përfaqësues nga Ministria e Integrimeve,

GRESA SELIMI: Faleminderit! Jam Gresa Selimi, nga Ministria e Integrimit Evropian.

Sa për me plotësua Albertin nga Këshilli Gjyqësorë. Gjatë javës së kaluar gjatë misionit të procesit të liberalizimit të vizave në monitorimin e një nga rekomandimet sa i përket transferim të gjyqtarëve është përmendur në fund edhe zgjidhja më afatgjate edhe çështja e plotësim ndryshimit apo adresimit të komenteve sa i përket Ligjit për kundërvajtje.

Për faktin se ata po kërkojnë të bëjnë transfero një numër të madh të gjyqtarëve për procedura për afat kohë më të gjatë në departamente të krimeve të rënda

Në departamentet të krimeve të rënda, tu e pas parasysh këtë Këshilli Gjyqësor nuk mundet t'i dërgojë gjyqtarët pa përvojë domethënë tash që i rekruton e është mirë që gjyqtarët aktualisht, të cilët veç gjinden në departamentet për kundërvajtje me ristrukturimin, domethënë me komentet që edhe po propozon Këshilli Gjyqësor të distribuohen në departamentin ku edhe është, domethënë kërkohet nevoja.

Ajo e përshëndeti shumë këtë për faktin që edhe në Slloveni është një sistem i njëjtë edhe domethënë që kish pas, kish me tregu shumë rezultate. Andaj është mirë edhe që të përfshihen këto komentet, të cilat edhe përfaqësuesi nga Këshilli Gjyqësor i ka përmend. Faleminderit shumë!

KRYESUESJA: Faleminderit, shumë Gresa!  
Përfaqësues nga Policia e Kosovës zoti Krasniqi, urdhëroni!

HAXHI KRASNIQI: Faleminderit! Përshëndetje të gjithëve,  
Edhe Policia e Kosovës është njëra prej organeve që do të jap shumë influenca në këtë ligj, do të jep kontributin e vetë për grupet punuese mirëpo një pikë që tash kisha dashur ta cek edhe që më kanë lut që ta përcjell këtë është parashkrimi i kundërvajtjeve, pikë me të cilën kemi probleme.

Ne kemi edhe një propozim konkret këtu, por ndoshta do të vjen koha kur do të japim të gjithë kontributin tonë nga defektet ne i kemi parë qysh do të mund ta tejkalojmë dhe qysh do të mund mos të na vijë në shprehje ekzekutimi kërkesave për njerëz dhe parashtrimi i shumë planeve. Mirëpo, kontributi jonë do të jetë shumë aktiv. Jemi tepër të interesuar që ky ligj me qenë sa më i mirë dhe më i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, shumë!  
Ne si komision vijmë me një konstatim të fundit që ligji është i punuar mirë, por megjithatë qëllimi i takimit apo i dëgjimit publik me akterë të ndryshëm është që

edhe njëherë të rishikohen mundësitë që mos të na bëhet ndonjë lëshim qoftë edhe teknik i cili do të na pengonte neve nesër në zbatim.

Gjithë ata të cilët direkt merren me zbatimin e ligjit dhe do të jetë edhe një ligj edhe më i qartë dhe më lehtë i pranueshëm edhe për vetë qytetarët, sepse shqiptimet e kundërvajtjeve do t'i godasin të gjithë ata, të cilët shkelin dispozitat e këtij ligji nesër. Sido që të jetë unë po mendoj që të gjitha komentet nga përfaqësues janë komente shumë pozitive dhe secili nga ju keni mundur të evidentoni edhe ndonjë lëshim deri tash përveç neve si komision dhe në takimet pastaj të ardhshme do të hyjmë nën për nën të shqiptimit të projektligjit i cili ka çështje të cilat mund t'i ngrit është mirë t'i drejtojmë me shkrim në administratën e komisionit paraprakisht dhe pastaj secili do të ftohet që të jeni në takimet e grupit punues.

Sido që të jetë unë e shoh të arsyeshme që prezentë janë këtu edhe disa nga anëtarët e komisionit dhe secili prej tyre në qoftë se ka ndonjë koment lidhur me projektligjin sot kur kemi këtu kohën e dëgjimit publik mund të marrin fjalën. Milena!

MILENA MILIČEVIĆ: Hvala! Ja po ko zna koji put moram da skrenem pažnju na prevod. Prekršaj se može izvršiti delom ili nedelom.

Mislim da bi trebalo da stoji činjenjem ili ne činjenjem jer nedelo - znate šta je nedelo. A to je u članu 8: Prekršaj se izvršava nedelom, kada je izvršilac propustio izvršenja dela koje treba da izvrši.

Znači, trebalo bi tu da se promeni i isto, da se prekršaj izvršava ne činjenjem, kada je izvršilac prepustio da preduzme određeno činjenje koje je trebao da izvrši.

Ima puno još primera, a ja sam ovde zabeležila, ali ne bih trebala da ih nabrajam sada, inače imaćemo prilike za to. I drugo kada se govori da sud prosudio je dokaze u skladu sa njegovim uverenjem, trebalo bi u skladu sa svojim, gde možete trećem licu jer ima dosta dosta nejasnoća ali ja se nadam da će to da se u radnoj grupi ispravi i kada budemo radili član po član. Hvala!

KRYESUESJA: Faleminderit, shumë zonja deputete. Që ka ndonjë lëshim eventual në përmbajtjen e ligjit mund të ketë edhe probleme të natyrës etnike që mund të jenë edhe probleme të përkthimit, por sido që të jetë kjo është puna që ne tash duhet ta bëjmë gjatë takimit të sotëm e tutje, në mënyrë që t'i eliminojmë të

gjitha paqartësitë e mundshme në ligj me qëllim që ligji të jetë më lehtë i zbatueshëm. Zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Përsëritet për të gjithë!

Ajo çka është deklaruar edhe nga ana e Kuvendit në lexim të parë i është dhënë përkrahje në parim. Po e shoh që edhe shumica nga ju që i kemi ftuar sot e ndani të njëjtin mendim. Ky ligj i plotëson kushtet dhe kriteret e asaj që ne e kemi pasur synim nga e kaluara, por ju më shumë që e keni bartur nëpër duart e juaja institucionit të juaj edhe pse është vonuar shumë, thënë të drejtën.

Edhe për arsye që ka mbetur gjithmonë në procedurë, por mbi të gjitha e ka ngarkuar edhe sistemin gjyqësor, siç e potencoi edhe drejtori i Këshillit, sa herë është folur për lëndët e grumbulluara janë apostrofuar këto lëndë, pa bërë ndonjë dallim në mes atyre që kanë pasur me peshë të rëndë apo edhe këto që janë të lehta.

Sido që të jetë, unë po mendoj që ju duhet të kontribuoni prapë një pjesë e grupit punues të Komisionit për dy qëllime. E para – terminologjia e re që është përdorur në këtë ligj kërkon kujdes të veçantë edhe nga ana jonë, por edhe nga ju, sepse modalitetet që i keni marrë edhe shembujt që i keni marrë apo praktikën që i keni marrë nga vendet tjera, keni bashkërenduar apo i keni fuzionuar në atë projektligj, edhe të cilat tash në praktikë, dua të jem të qartë edhe në interpretim edhe në këtë që e tha kolegu, sidomos te nenet 7,8,9 është praktikë dhe përvojë e re dhe gjyqtari do të duhet ta dijë si do ta interpretojë.

Besoj që Policia e Kosovës duhet të jetë më shumë e informuar në këtë aspekt. Ajo çfarë kërkohet është implementimi në praktikë, sepse bart kompetenca të mëdha dhe sigurisht se do të duhet jo vetëm shtim të numrit, por ngritja e kapaciteteve të brendshme, që unë besoj se i kanë, por sigurisht se duhet një riorganizim i ri. Edhe pse, ju po e shihni që me projektligje të caktuara apo ligje të caktuara shumë kompetenca tash po i bartim te Policia e Kosovës dhe normalisht që besoj se do të kontribuojnë në rritjen e efikasitetit dhe të sigorisë në vend. Ajo çka për mua është e rëndësishme, është se në kuadër të kësaj t'i bashkërendojmë këto mendime dhe veprime. E dini që numri i madh i aksidenteve në vendin tonë është në rritje, asnjëherë nuk është në rënie edhe zgjidhja apo moszgjidhja përmes instancave gjyqësore ka lejuar që njerëzit në prag të veprimeve të mos jenë pjesë e ndëshkimeve, atëherë ngritën edhe këto shqetësime që i tha kolegia nga Ministria e Integrimeve evropiane, që janë shqetësimet edhe të partnerëve tanë ndërkombëtarë në ecjen tonë drejt BE-së.

Çështja e transformimit të gjyqtarëve, unë besoj se duhet të kemi kujdes, jo pse ata njerëz nuk kanë kapacitete që të kalojnë në instanca tjera, por nuk kemi ligje tjera dhe Këshilli gjyqësor domethënë, ka rregullore të veçanta për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

Sido që të jetë, unë besoj apo kërkoj pasi që jemi dhe do të jem edhe pjesë e grupit punues, kërkoj që këto që i keni t'i sillni me shkrim paraprakisht edhe të shqyrtojmë e diskutojmë nëse mund të jenë pjesa e amanadamentimit të këtij projektligji. Por, parimisht po kuptohet që është ligji i avancuar dhe ka marrë edhe përkrahjen e Kuvendit dhe nga diskutimet që dalin këtu, besoj se do të ecim në afatin më optimal dhe ky ligj të zë vendin e vet në implementim sipas normave që i kemi dhe rregulloreve, qoftë tonat qoftë të tjera. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, Armend. Dëshiron dikush tjetër prej anëtarëve të komisionit? Zoti Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Përsëritet për kolegët deputetë. Përsëritet për zyrtarët nga ministritë përkatëse, nga policia por edhe shoqëria civile.

Edhe unë dua t'i bashkëngjitem vargut të diskutuesve, respektivisht debateve në përkrahje të një ligji të tillë, duke spikatur në mënyrë të veçantë rëndësinë që ka ky ligj, jo vetëm për përmbajtjen por edhe për shkakun se për herë të parë pas kaq shumë kohësh po miratojmë një ligj që është ligj i Republikës së Kosovës dhe kjo është edhe arsye që ne po i japim përkrahje të fuqishme edhe në leximin e parë duke e kaluar në komisionin, pastaj edhe në seancë plenare dhe tash në fazën e dëgjimit respektivisht në fazën kur do ta diskutojmë në grupin punues.

Por kjo pikërisht duhet të na bëjë më të vëmendshëm dhe më të përgjegjshëm që diçka nëse ka mbetur për t'u plotësuar në këtë ligj, ne ta bëjmë në këtë fazë për faktin se është për herë të parë ky ligj dhe për faktin se shpesh na ka ra që shumë ligje të rikthejmë në kuptimin që të bëjmë ndryshime dhe plotësime dhe ndoshta do të ishte një rast i mirë që përmes këtij ligji mos të lëmë shumë punë që pastaj në praktikë të na ndodhin gjëra të tilla që ne sërish të rikthehemi dhe sërish të bëjmë ndryshime e plotësime të këtij ligji.

U thanë qëllimet e këtij ligji dhe jemi të dakorduar të gjithë se vërtet është një ligj që e ka një qëllim shumë të qartë dhe të adresuar dhe po ashtu është një ligj që e ka një strukturë jashtëzakonisht të ndërtuar mirë, por një nga qëllimet që u përmend, që është përveç reformës efikasiteti dhe efektiviteti i institucioneve të drejtësisë

dhe duke pasur parasysh këtë fakt unë nuk jem marrë me analizën e normave, të gjobave, sasive ta quaj kuptimisht, por u tha këtu dhe u ngritën dy çështje nga diskutimet, çështja e një sasive jashtëzakonisht të madhe të kundërvajtjeve dhe çështja e parashtrimeve të lëndëve të tilla.

Dhe unë dua të vë theksin tash, a mos është ndonjëra prej arsyeve gjobat, në kuptimin e shumës dhe a janë analizuar, a janë të përshtatshme për gjendjen sociale që e kemi ne sot në Republikën e Kosovës.

Unë tash kam parë kufizimet, fjala po bie 10, 20 deri në 50, deri në 200, deri në 2000 dhe jo duke u ndalur në secilën veç e veç por që u përmend edhe atë që zoti Taulant që është një privilegjojë, në thonjëza ta quaj... që qytetarët nëse shkojnë herët ta shlyejnë këtë gjobë e kanë 50 përqindëshin por është bërë një analizë që vërtet të mos ketë shumë lëndë pastaj për shkak se është sasi shumë e madhe e kundërvajtjeve që realisht e shkakton ... pastaj për ndonjë pengesë të shumat e mëdha por një analizë që do të duhej të bëhet financiare në pengesa për realizimin e parashtrimit të kundërt.

Po e ngris këtë çështje duke pasur parasysh se ne gjatë fazës së punës të grupit punues do të kemi mundësi që të diskutojmë edhe këtë çështje por që sponzorizuesit por edhe akterët tjerë më shumë të përkushtohen në këtë drejtim që të realizojmë atë qëllimin që e thash në fillim që ky ligj vërtet të jetë i plotësuar mirë që të mos ketë nevojë më vonë për ndryshime e plotësime, gjë që koha gjithmonë mund të sjell risi dhe gjithmonë duhet nënshtruar edhe në aspektin kohor apo çështje të caktuar por ne ta bëjmë punën më të mirë në mënyrë që të ketë një qëndrueshmëri më të gjatë një ligj i tillë. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit Agim! A e do ndokush tjetër fjalën? Urdhëro! Është përfaqësuesi i OSBE-së.

BEKIM KODRALIU: Po, unë vetëm shkurtimisht të them disa fjalë. Unë jam Bekim Kodralia, vie nga OSBE-a, departamenti për te drejtat e njeriut. Fillimisht, edhe ne e kemi përkrahur Projektligjin dhe më konkretisht, gjatë vitit të kaluar e kemi përkrahur edhe me organizimin e konsultimeve publike gjegjësisht Ministrinë e Drejtësisë.

Sa i përket strukturës, konsiderojmë se është në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare dhe konsiderojmë se është më i qartë se sa që është ligji në fuqi, domethënë është më gjithpërfshirës.

Sa i përket disa çështjeve që i kemi dorëzuar në Kuvendin e Kosovës, vetëm sa për sqarim, neve kemi qenë edhe pjesë aktive e konsultimeve publike në nivelin e Ministrisë dhe pothuaj se shumica e sugjerimeve të OSBE-së veç janë reflektuar në projektligj. Megjithëkëtë janë edhe disa sugjerime, ku ndoshta janë teknike por do të kishim mund t'i diskutojmë gjatë grupeve punuese. Përndryshe, jemi të hapur për bashkëpunim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Realisht në strukturën e përmbajtjes ky është një ligj shumë i mirë kështu që na e ka lehtësuar punën neve si Komision funksional për këtë çështje.

Por, desha të ju njoftoj se ne si Komision kemi caktuar grupin punues që do të merret me rishikimin e Projektligjit dhe për amendamentim. Atë grup punues e kryeson zoti Armend Zemaj dhe anëtarë janë deputetja Milena dhe deputeti Agimi.

Grupi punues do të caktojë agjendën e takimeve dhe do të ju ftoj të gjithë juve, por nga ky takim unë apeloj te ju që të paraqitni të gjitha komentet tuaja me shkrim paraprakisht në administratën e Komisionit, por gjithashtu edhe shoqëria civile edhe mekanizmat tjerë vendorë e ndërkombëtarë të cilët mendojnë se mund të kontribuojnë në projektligj të marrin projektligjin nga Kuvendi dhe të dhënë komentet e tyre me të vetmin qëllim që ligji të jetë më mirë i zbatueshëm, do të thotë të punohet më mirë dhe të ketë lehtësira në zbatim.

Zakonisht te ne, jo vetëm çështja e sanksionimeve dhe shqiptimi i tyre, por në përgjithësi sistemi shoqëror ka telashe me vonesat apo parashkrimet e lëndëve të caktuara. Ka modele të ndryshme të cilat do të lehtësojnë që të mos vjen deri te parashkrimi i lëndëve të caktuara dhe mendoj që të gjitha ato të gjitha mund të diskutohen në grup punues dhe pastaj të dalin në formë të amendamenteve në mënyrë që të plotësohet ligji dhe të mos ballafaqohemi edhe me problemin e parashkrimeve.

Është mirë që përmes këtij ligji të arrijmë efekt që edhe e ka ligji dhe sistemi i drejtësisë në tërësi. Veç gjobave apo dënimeve, të arrijmë të edukojmë qytetarët që sa më pak të jenë pre e ndëshkimeve, nga institucionet dhe këtë mund ta bëjmë të gjithë së bashku. Prandaj, unë edhe apeloj që të gjithë së bashku të punojmë që ta bëjmë ligjin më të mirë, më të plotë dhe më lehtë të zbatueshëm për të gjithë.

Ne nuk kemi sot më tepër çfarë të diskutojmë. Presim komentet tuaja me shkrim dhe po shpresojmë e duam të besojmë se do të jenë pjesë e takimeve të grupit punues. Ndoshta data do të jetë 28 mars.

ARMEND ZEMAJ: Komentet mund t'i bëni parapraakisht.

KRYESUESJA: Faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.  
Mirupafshim!